



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:139374  
Datë: 17.05.2024  
Numri i dokumentit: 05703663

**C.nr.1005/21**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil,** gjyqtari Genc Hasani, me bashkëpunëtore profesionale Valbona Berisha – Tahiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. B., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Veton Uka, avokat nga Vushtrria, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës - Polica e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, kompensim i pagës së trembëdhjetë, lartësia e objektit të kërkesës 1695.63 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 17.05.2024, jep këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B. B. ashtu që detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës - Polica e Kosovës, që në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020, t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 565.21€, apo në total, shumën prej 1695.63 euro, me kamatë ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë datë 30.06.2021, e gjer në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**II. DETYROHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës - Polica e Kosovës, që paditësit B. B. t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 135.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja përmes përfaqësuesit të tij, me datë 30.06.2021, ka paraqitur padi, të cilën e ka precizuar me datën 20.11.2023, kundër të paditurës, ku si kërkesë përfundimtare ka qenë vetëm kërkesa për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, për fund vitet 2018, 2019, 2020. Ka theksuar se në bazë të udhëzimit administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018, përkatësisht nenin 29 par.2 parashihet se personelit të policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente

pagën e rregullt mujore në fund të vitit. Tutje ka shtuar se që nga hyrja në fuqi e udhëzimit në fjalë e deri më tani paditësi nuk i ka gëzuar këto beneficione, edhe përkundër faktit se kanë bërë kërkesë tek e paditura me datën 07.06.2021, por që deri më tani e njëjta nuk i ka kthyer përgjigje. Nga këto arsye ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit në emër të pagës së fund vitit t'ia paguaj shumën prej nga 565.21 Euro, për vitet 2018, 2019, 2020, apo në total shumën prej 1695.63 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën përfundimtare.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për taksë gjyqësore për padi shumën prej 20.00 euro, për kërkesës shumen prej 80€, për padi shumën prej 104.00 euro, si dhe për precizim shumën prej 104.00 euro.

E paditura me datë 02.04.2024, ka parashtruar përgjigje në padinë me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se e njëjta është e palejuar sepse paditësi nuk i ka shterur mjetet e brendshme të ankimit, ashtu siç parashihet me nenin 78 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 79 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës. Nga këto arsye ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, që në këtë rast rezulton se padia e paditësit është e bazuar për arsye se: Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit me nr. Reference ....., dt.07.06.2021, i cili iu është bashkangjitur shkresave të lëndës.

Nga vërtetimi i punësimit të cekur më lartë gjykata konstatoi se paditësja e ka filluar punën te e paditura nga data 15.04.2002 dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 565.21€.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për kërkesën e aprovuara të paditësit, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13, për vitet 2018, 2019, 2020.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.*

Nga interpretimi i dispozitës të lart cituar të Udhëzimit Administrative 02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të nxjerr nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar sepse paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitoj si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësi, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës, nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi, ka vlerësim të kënaqshëm, të performancës dhe të njëjtit nuk iu është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, për gjatë viteve 2018, 2019, 2020. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësit.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019, 2020, gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit, të vlerësuar si më lart, nga e cila rezulton paga të cilën e realizon paditësja, andaj të njëjtit për vitet 2018, 2019, 2020, i takon shuma ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara, që t’ia kompensoj paditësit, pagat e 13-ta, për fund vitet 2018, 2019, 2020. Andaj, paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar ne nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura ju ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën e gjykuara, si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 10.11.2021, dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. Gjykata ne shkresat e lendes posedon kërkesën e dorëzuar nga përfaqësuesi i paditësit për kompensim pranë te paditurës, ku e paditura i ka refuzuar te njëjtën, e qe nga ai moment i njëjti ka paraqitur padi pranë kësaj gjykate. Andaj, lidhur me kërkesën ne fjale gjykata vlerëson se padia është e rregullt dhe e paraqitur brenda afateve ligjore.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzime e procedurës, gjykata e ka bazuar në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet në shumë prej 124.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 104.00 € dhe në emër të taksës për padi shumën prej 20.00 €. Gjukata nuk i ka aprovuar shpenzimet për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr1005/2021, datë 17.05.2024**

**Gjyqtari,**  
Genc Hasani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.